



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr.6/36 i Regj. Themeltar
Nr.6/36 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Tom Ndreca	Kryesues
Evelina Qirjako	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 14/04/2016, mori në shqyrtim çështjen penale me nr.36 Regj.Them., që i përket:

KËRKUESE: *Prokuroria e Përgjithshme, e përfaqësuar në gjykim nga prokurori Madrid Kullolli.*

I PANDEHUR: *Myqerem Tafaj, i biri i Ramazan dhe i Halime, i dtl. 14.11.1957, lindur në Trebisht, Dibër dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga “Mahmut Fortuzi”, nr.6, me arsim të lartë, me gjendje gjyqësore “i padënuar”, me gjendje civile “i martuar”, me shtetësi shqiptare, i hetuar në gjendje të lirë, në mungesë, i përfaqësuar në gjykim nga Av. Brikena Kasmi, e zgjedhur nga i pandehuri me prokurën e posaçme nr.161 Rep., nr.41 Kol., dt. 21.04.2015.*

AKUZA: *“Shpërdorimi i detyrës”*

BAZA LIGJORE: *Neni 248 i K.Penal.*

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Tom Ndreca, dëgjoi pretendimet e palëve, mori e administroi provat e nevojshme, dëgjoi përfundimisht palët që kërkuan:

Prokurori Madrid Kullolli:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Myqerem Tafaj, i biri i Ramazan dhe i Halime, i dtl. 14.11.1957, lindur në Trebisht, Dibër dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga “Mahmut Fortuzi”, nr.6, me arsim të lartë, i padënuar, i martuar, me kombësi e shtetësi shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin nr.030437586, i hetuar në gjendje të lirë, për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
2. Dënimin e të pandehurit Myqerem Ramazan Tafaj për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal, me 1 (një) vit burgim.

Mbrojtësja e të pandehurit Myqerem Tafaj, Av. Brikena Kasmi:

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Prof. Dr. M.Tafaj, i akuzuar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar në nenin 248 të K.Penal, pasi ai nuk e ka kryer këtë vepër penale.

dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes dhe procedurat e ndjekura.

Më dt. 17.04.2015, Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr.04 të vitit 2015 për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Falsifikimit të dokumentave”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të K.Penal, në ngarkim të të pandehurit Myqerem Tafaj, në bazë të kallëzimit të paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

I pandehuri Myqerem Tafaj është aktualisht deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa në vitet 2006-2013, kohë në të cilën pretendohet të jetë kryer vepra penale, ka qenë Ministër i Arsimit dhe Shkencës.

Nga ana e organit të akuzës është pretenduar se duke nxjerrë urdhrin nr.381, dt. 05.08.2011 “Për hapjen e programeve të ciklit të parë që përfundojnë në Bachelor dhe programeve të ciklit të dytë që përfundojnë me Master i Shkencave, të Shkollës së Lartë Private “Vitrina”, i pandehuri ka kryer veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

II. Rrethanat dhe fakti penal objekt akuze.

Më dt. 03.05.2010, Shkolla e Lartë Private “Vitrina” ka depozituar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës një kërkesë me objekt dhënien e lejes për hapjen e programeve të reja të studimit për vitin 2011 duke kërkuar të hapë programet: Inxhinieri Elektrike; Mekatronikë; Inxhinieri Ndërtimi; Administrim Publik; Gjuhë dhe Letërsi Arabe; Stomatologji; Mjekësi dhe Farmaci.

Kjo kërkesë i është kaluar për vlerësim Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, i cili pasi ka kryer vlerësimin, me vendimin nr.192, dt. 24.06.2011, ka vendosur për tre prej degëve të kërkuara, përkatësisht Inxhinieri Elektrike, Mekatronikë dhe Administrim Publik, që Bachelor të mos hapen, në Stomatologji Master i Shkencave të mos hapet, Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Arabe të hapet, ndërsa për degët Inxhinieri Ndërtimi, Mjekësi dhe Farmaci nuk ka dhënë një vlerësim përfundimtar por i ka lënë disa kushte dhe detyrën, që pasi subjekti kërkuës t’i plotësojë ato, të vërë në dijeni Këshillin e Akreditimit në mënyrë që ky të ribëjë procedurën e verifikimit.

Me urdhrin nr.381, dt. 05.08.2011, “Për hapjen e programeve të ciklit të parë që përfundojnë në bachelor dhe programeve të ciklit të dytë që përfundojnë me Master i Shkencave, të Shkollës së Lartë Private “Vitrina”.”, i pandehuri ka vendosur:

URDHËROJ:

1. Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në “Inxhinieri Elektrike”, “Mekatronikë”, “Inxhinieri Ndërtimi”, “Administrim Publik”, “Gjuhë dhe Letërsi Arabe” si dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Hapjen e programeve të studimit të integruara të ciklit të dytë në “Stomatologji”, “Mjekësi”, “Farmaci” si dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Programet e studimeve të ciklit të parë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, realizohen me 180 kreditë dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve studimi lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.
4. Programet e studimeve të integruara të ciklit të dytë të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, realizohen me jo më pak se 300 kreditë dhe kohëzgjatja normale e tyre është jo më pak se 5 vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve studimi lëshohet diplomë universitare “Master i Shkencave” në fushën e arsimit të kryer.
5. Shkolla e Lartë Private “Vitrina” dërgon në MASH brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, një raport për plotësimin e kushteve të vëna nga Këshilli i Akreditimit (shih shtojcën bashkëngjitur urdhrit).
6. Programet studimore fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

Shtojca bashkangjitur këtij urdhri (shtojca 1 e referuar në urdhër) është pasqyrim i asaj që Këshilli i Akreditimit ka përfshirë nga pika 1-7 në pjesën arsyetuese të vendimit të tij si mangësi të programeve përkatëse për të arsyetuar sipas rastit vlerësimin negativ apo pozitiv që ka dhënë, pra si kushte që duhet të plotësoheshin nga subjekti kërkues.

Me shkresën nr.4265/1 prot., dt. 05.08.2011 të firmosur nga Drejtoresha e Kabinetit pranë Ministrisë së Arsimit, ky urdhër dhe shtojca bashkangjitur tij i janë përcjellë Shkollës së Lartë Private “Vitrina”, e cila nuk rezulton të ketë kthyer përgjigje në lidhje me plotësimin ose jo të kushteve të vendosura në shtojcën bashkangjitur urdhrit.

Në vitin 2011-2012 janë hapur në Shkollën e Lartë Private “Vitrina” programet e mësipërme të studimit.

Faktet e mësipërme u provuan me deklaratimet e dëshmitarëve në gjykim, shtetasve Avni Meshi, Emil Lamani, Bardhyl Musai, Edlira Late, Arian Shahini, Dhora Çadra, aktet shkresore të paraqitura në gjykim si dhe në tërësi aktet e procedimit penal nr.4 të vitit 2015 (6 fashikuj).

III. Në lidhje objektin e gjyimit.

Nga ana e organit të akuzës, Prokurorisë së Përgjithshme, mbi bazën e fakteve dhe rrethanave të sipërcituara, është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit **Myqerem Tafaj** për kryerjen e veprës penale të **“Shpërdorimit të detyrës”** të parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe dënimi i tij me 1 (një) vit burgim, duke pretenduar si më poshtë vijon:

- Urdhri nr.381. dt. 05.08.2011 është nxjerrë nga i pandehuri Myqerem Tafaj në cilësinë e Ministrit, në kundërshtim me Ligjin nr.9741, dt. 21.05.2007 *“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, nenet 43/3, 44/4, 44/7, 59, 60 dhe 63/4 të tij, VKM-në nr.303, dt. 01.07.1999 *“Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”*, VKM-në për Krijimin e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, VKM-në nr.608, dt. 06.05.2009, nenet 5/2 dhe 8, Udhëzimin nr.11, dt. 28.02.2011 lidhur me *“Procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë...”*, Kreu I, neni 1 mbi procedurat e licensimit, pika 5 dhe Kreu III, nenet 1,2,3,9 dhe në mospërmbushje të rregullt të detyrës;
- Paligjshmëria në nxjerrjen e urdhrit për hapjen e programeve të studimit, rezulton qartazi nga mosrespektimi i të gjitha parashikimeve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mënyrën e hapjes së programeve të reja të studimeve, përkatësisht neni 2 i Ligjit *“Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”* dhe nenet 43, 44/4/7, 60, 63/4 të tij, si dhe nenet 5 dhe 9 të Udhëzimit nr.11/2011. Edhe pse Këshilli i Akreditimit kishte dhënë vlerësim negativ, i pandehuri, në kundërshtim me këtë vendim, ka miratuar kërkesën e paraqitur nga Shkolla e Lartë Private “Vitrina” për degët Inxhinieri Elektrike, Mekatronikë, Administrim Publik, Stomatologji;

- Gjithashtu, edhe pse për programet Inxhinieri Ndërtimi, Mjekësi dhe Farmaci, Këshilli i Akreditimit ka kërkuar që të njoftohet zyrtarisht për plotësimin e kushteve të vëna, në mënyrë që pas verifikimit të rifillojë procedurën për miratimin e programeve, i pandehuri ka vijuar me hartimin e urdhrit të hapjes duke mos lejuar një procedurë tjetër vlerësimi;
- Në hartimin e këtij urdhri ish ministri nuk ka ndjekur procedurën normale të hartimit dhe qarkullimit të akteve në MASH duke ngarkuar për hartimin dhe konceptimin e tij Drejtoreshën e Kabinetit dhe duke shmangur Drejtorinë e Zhvillimit të Arsimit Jopublik në MASH, në kundërshtim me çfarë parashikohet në rregulloren e brendshme të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të miratuar me Urdhrin nr.6, dt. 10.01.2011 të Ministrit të Arsimit;
- Urdhri nr.381, dt. 05.08.2011 është nxjerrë pa një vlerësim teknik dhe ligjor të shoqëruar me dokumentacionin përkatës pasi ai është nxjerrë pa u kryer një proces i mirëfilltë vlerësimi nga ekspertë të fushave përkatëse pranë ministrisë, por edhe ato vlerësime negative që janë përcjellë nuk janë marrë parasysh;
- Në vijim, edhe pse në pikën 5 të urdhrit është shprehur se: *“Shkolla e Lartë Private Vitrina dërgon në MASH Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri një raport për plotësimin e kushteve të vëna nga Këshilli i Akreditimit”*, nga hetimet e kryera ka rezultuar se këto kushte nuk janë plotësuar nga Shkolla e Lartë “Vitrina” dhe as nga ana e ministrisë nuk ka patur një proces mbikëqyrjeje në lidhje me plotësimin ose jo të këtyre kushteve;
- Nxjerrja e urdhrit nr.381, dt. 05.08.2011 është bërë në mënyrë fiktive pasi ka rezultuar se programet e cituara në urdhër janë hapur disa vite para daljes së këtij urdhri, ndërkohë që i pandehuri jo vetëm që nuk e ka ndaluar zhvillimin e programeve të filluara me mungesa të theksuara teknike dhe ligjore por e ka legjitimuar veprimtarinë e tij;
- Kundërligjshmëria në veprimet e subjektit qëndron edhe në faktin se ka tejkaluar tagrin e funksioneve të tij duke anashkaluar vlerësimin e Këshillit të Akreditimit, i cili njëkohësisht për dhënien e këtij vendimi është bazuar në vlerësime nga ekspertë sipas fushës që mbulojnë;
- Në kundërshtim me çfarë ka vendosur Këshilli i Akreditimit, i pandehuri ka vendosur hapjen e programeve mësimore. Ky veprim i tij është kryer me dashje të drejtpërdrejtë pasi edhe pse ka patur detyrimin ligjor për ta respektuar, edhe pse vlerësimi i dhënë nga institucioni kompetent ishte i qartë (vlerësim negativ), ai ka vendosur hapjen në mënyrë të kundraligjshme;
- Veprimet e të pandehurit kanë sjellë si rrjedhojë hapjen e programeve mësimore të cilat nuk janë në përputhje me kriteret ligjore, krijimin e mundësisë subjektit privat “Vitrina” që pavarësisht se nuk plotësonte standardet ligjore të zgjeronte aktivitetin në fushën e arsimit dhe të ofronte programe jo cilësore studimi, me pasoja financiare për individët dhe për shtetin si garant i standardeve të larta mësimore. Kështu, nga ana e të pandehurit

janë lejuar të zhvillojnë studimet në mënyrë të kundraligjshme një numër i madh studentësh.

Nga ana e mbrojtëses së të pandehurit u pretendua se i pandehuri Myqerem Tafaj duhet të deklarohet i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar pasi:

- Nga ana e organit të akuzës konfundohej figura e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal përse i takon kryerjes së një veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me ligjin. Funkzioni i detyrës së ministrit parashikohet nga kushtetuta si dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë fushën e veprimtarisë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit. Konfondimi lidhet me disa aspekte, me interpretimin e zgjeruar të dispozitës 44/1 e cila parashikon refuzimin në rastin e vlerësimit negativ për të gjitha programet, ndërkohë që në çështjen objekt akuze 3 nga programet janë vlerësuar me kushte dhe një pozitivisht;
- Nga ana tjetër, respektimi i nenit 44/1, pa marrë në konsideratë të drejtën e palëve private për t'u ankuar, që është tërësisht dhe vetëm në diskrecion të Ministrit, është shkelje e parimit të barazisë së armëve dhe të drejtës së palëve për tu mbrojtur. Gjithashtu, respektimi i vetëm kërkesave teknike nga ana e ministrit e zhvesh detyrën dhe funksionin e tij nga përgjegjësia politike, përgjegjësi e cila është e ndryshme nga ajo e një zyrtari tjetër të administratës publike. Sa më sipër, mbështetja e akuzës në nenin 44/1 çënon thelbësisht parimin e sigurisë juridike;
- Gjatë gjykimit u provua se pas dhënies së vendimit nga ekspertët në lidhje me hapjen e disa programeve është ndjekur një procedurë dëgjimi nga ana e të pandehurit me përfaqësues të palëve dhe dëshmitarët dëshmuan në gjykim qartë dhe prerë se hapja e programeve të reja të studimeve është në diskrecion të ministrit dhe se kishte dhe raste të tjera kur vendimi i Këshillit të Akreditimit është ndryshuar nga ana e tij;
- Në përputhje me nenin 44/1 i pandehuri ka vepruar plotësisht në ushtrim të kompetencave të tij të njohura nga ligji, në diskrecionin e tij për të marrë në shqyrtim një ankesë administrative në bazë të një procesi hetimor administrativ për një çështje që përfshihet në fushën e veprimtarisë së mbuluar nga ministri i arsimit;
- Qartësia ligjore, si një nga elementët formalë të garantimit të zbatimit të parimit të shtetit të së drejtës, përfshin në vetvete interpretimin eksplicit të një norme (fjalë për fjalë) si dhe përcaktimin e qartë të fushës së kompetencave të një organi kompetent;
- Prokuroria nuk ka evidentuar saktë bazën ligjore si dhe aktet nënligjore mbi të cilat ka mbështetur akuzën;
- Akuza mbështetet në nenin 62 të ligjit tashmë të shfuqizuar që lidhet me procedurën e akreditimit dhe jo atë të hapjes së programeve të studimit, të cilat janë dy procedura krejtësisht të ndryshme;

- Nga deklarinimet e dëshmitarëve në gjykim u vërtetua plotësisht fakti se është në diskrecion të Ministrit marrja e vendimit përfundimtar në lidhje me hapjen e një programi studimi;
- Hapja e programeve për Shkollën e Arsimit të Lartë Privat Vitrina nuk është i tillë që të konsiderohet si mosveprim në kundërshtim me ligjin dhe që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës në kuptim të nenit 248 të K.Penal;
- Pasoja e pretenduar nga akuza nuk vërtetohet dhe në asnjë rast nuk u arrit të provohet në seancat gjyqësore të realizuara në këtë proces. Në gjykim u provua se nga dokumentat e administruara në dosjen gjyqësore, Raport Monitorimi MASH (2012), vihet re se nuk ka një konstatim të problematikës që lidhet me akuzën, të njejtin qëndrim ka mbajtur edhe grupi tjetër i ekspertëve për vitin 2013, ku në asnjë prej tyre nuk ka rekomandim konkret për shkelje të konstatuara të subjekti “Vitrina”;
- Me vendimin nr.317, dt. 16.03.2012 Këshilli i Akreditimit me të njëjtët anëtarë, ka miratuar vetëm pak muaj pas daljes së urdhrin për hapjen e programeve, aplikimin e subjektit për riorganizimin e saj ku bëjnë pjesë edhe fakultetet që mbulojnë programet e hapura me urdhrin nr.381, dt. 05.08.2011;
- Programet e studimit janë njohur sërish nga ministria pasardhëse e arsimit me urdhrin nr.33, dt. 19.09.2014 ku pasoja e legjitimuar është arsimimi i studentëve të cilët kanë zhvilluar studimet e tyre pranë subjektit “Vitrina” për periudhën kohore 2011-2014;
- Evidentohet se akuza ka një mungesë argumentimi të elementëve të anës objektive dhe subjektive të cilat rrëzojnë çdo pretendim të ngritur për kryerjen e një veprë penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Nga akuza nuk u provua asnjë motiv i të pandehurit për të kryer veprën fare;
- Nga akuza nuk u provua dashja si formë e fajit në kryerjen e veprës për të cilën i pandehuri është akuzuar.

IV. Qëndrimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Në lidhje me akuzën Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vëren se:

Veprimet e të pandehurit Myqerem Tafaj, të listuara nga organi i akuzës, nuk përmbajnë elementë të figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, për të cilën ai është akuzuar.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vëren se, përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t’iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë, organet proceduese penale përgjatë të

gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtuara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal. Legjislatori duke konkretizuar parimin e ligjshmërisë të shprehur në nenin 1, në pjesën e posaçme të Kodit Penal, ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse të dënimeve për to.

Sa më sipër, sipas të drejtës sonë penale, e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar vepra penale, të parashikuar nga ligji penal. Për këtë arsye, bashkëekzistenca e njëkohshme e elementeve të figurës së veprës penale ka një rëndësi të madhe sepse lidhet domosdoshmërisht me zbatimin e parimit të ligjshmërisë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, paraprakisht evidenton faktin se për të patur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e njëkohshme e të gjithë elementëve përbërës të saj, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer dhe kryesi i saj mbajnë përgjegjësi penale kur ekzistojnë të katër elementët e saj. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Për këtë arsye detyrë e çdo gjykate, është verifikimi i ekzistencën së njëkohshme të të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi i sjellë si i pandehur para një gjykate nuk mund të dënohet.

Në çështjen objekt gjykimi, nga ana e organit të akuzës është sjellë për gjykim përpara këtij Kolegji i pandehuri Myqerem Tafaj, duke u akuzuar ai për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Në përmbajtjen e nenit 248 të K.Penal, të ndryshuar me ligjin nr.9686, dt. 26.02.2007 “Për disa ndryshime në K.Penal të RSH”, sanksionohet se:

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në shtatë vjet.”

Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është parashikuar nga Kodi ynë Penal në Pjesën e posaçme të tij, në Kreun VII, Seksioni II, të titulluar: “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”. Sipas teorisë së të drejtës penale, kjo dispozitë merr në mbrojtje ato marrëdhënie juridike të vendosura **me ligj**, për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shtetëror si dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të shtetit, shtetasve dhe personave juridikë.

Objekt i kësaj vepre penale, janë ato marrëdhënie juridike të vendosura me ligj ose me akte normative me fuqinë e ligjit, të cilat sigurojnë veprimtarinë e rregullt e normale të aparatit shtetëror, institucioneve, të shërbimeve publike, si dhe mbrojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve dhe të shtetit. Nga kjo dispozitë rezulton se ligjvënësi i ka cilësuar si marrëdhënie juridike të rëndësishme, të cilat mbrohen posaçërisht nga legjislacioni penal, marrëdhëniet që kanë të bëjnë me përmbushjen e rregullt të detyrës, zbatimin e ligjeve dhe akteve normative me fuqinë e ligjit dhe jo të akteve të tjera nënligjore që nuk kanë fuqinë e tij. Në këtë kuptim, neni 248 i K.Penal, i sipërcituar është një dispozitë “*blanket*” e cila i referohet akteve të tjera ligjore që normojnë punën e personit që ushtron funksione publike, në rastin konkret, Ligji nr.9741, dt. 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar me ligjet nr.9832, dt. 12.11.2007 dhe nr.10307 dt. 22.07.2010. Sa më sipër, për ligjvënësin, cënimi i këtyre marrëdhënieve konsiderohet vepër penale.

Nga ana objektive vepra penale e shpërdorimit të detyrës kryhet me veprime aktive të kundraligjshme ose duke mos kryer veprime të caktuara (mosveprim), në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës. Pra elementi i parë i anës objektive të kësaj vepre penale janë veprimet ose mosveprimet e kryera nga personi i ngarkuar me një funksion publik, të cilat duhet domosdoshmërisht të jenë kryer:

1. Në kundërshtim me ligjin ose ligjet që normojnë veprimtarinë përkatëse të personit që ushtron funksion publik konkret;
2. Të përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës.
3. Të kenë sjellë si pasojë përfitime materiale ose jomateriale për vetë kryerësin ose për persona të tjerë ose të kenë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë.

Rezulton se i pandehuri Myqerem Tafaj ka kryer në vitet 2009-2010 detyrën e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Disa nga aktet ligjore dhe nënligjore që janë referuar nga organi i akuzës se normojnë veprimtarinë e të pandehurit në kuadër të ushtrimit të funksioneve të tij janë ndër të tjera edhe:

- Ligji nr.9741, dt. 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar me ligjet nr.9832, dt. 12.11.2007 dhe nr.10307 dt. 22.07.2010;
- Udhëzimi nr.11, dt. 28.02.2011 “*Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe të dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës*”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.303, dt. 01.07.1999 “*Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë*”;
- Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, e miratuar me urdhrin nr.6, dt. 10.01.2011 të Ministrit, etj.

Ky Kolegj vëren se, për të konkluduar nëse i pandehuri e ka kryer apo jo veprën penale për të cilën akuzohet, duhet që të evidentohet se ai ka kryer një veprim në kundërshtim me dispozitat ligjore ose duke shkelur një ndalim apo detyrim të parashikuar në to.

Nga ana e akuzës është pretenduar se duke nxjerrë urdhrin nr.381, dt. 05.08.2011 *“Për hapjen e programeve të ciklit të parë që përfundojnë në Bachelor dhe programeve të ciklit të dytë që përfundojnë me Master i Shkencave, të Shkollës së Lartë Private “Vitrina”.*”, i pandehuri ka kryer veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, duke pretenduar se ky urdhër është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin nr.9741, dt. 21.05.2007 *“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, VKM-në nr.303, dt. 01.07.1999 *“Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”* dhe në mospërbushje të rregullt të detyrës. Si dispozita konkrete të shkelura prej të pandehurit me nxjerrjen e këtij urdhri, akuza ka cituar nenin 44 të Ligjit për arsimin e lartë dhe Udhëzimin nr.11, dt. 28.02.2011.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se në përputhje me nenin 2 të K.Penal, askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për një vepër që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose si kundravajtje penale. Neni 1 dhe 1/a paragrafi i dytë i po këtij Kodi parashikojnë se veprat penale përcaktohen në K.Penal dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penale. Në rastin konkret, vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, “Shpërdorimi i detyrës”, është, ashtu siç është shprehur edhe më lart ky Kolegj, megjithëse e parashikuar në Kodin Penal, një dispozitë blanket, çka do të thotë se, për të konkluduar mbi ekzistencën e anës objektive të kësaj figure vepre penale, ky Kolegj do t’i referohet ligjit të posaçëm që normon ushtrimin e funksionit prej të pandehurit.

Në lidhje me aktet nënligjore të referuara nga organi i akuzës, ky Kolegj vëren se, rrezikshmëria e veprimeve apo e mosveprimeve si një element thelbësor i veprës penale është tipari material dhe esencial i saj. Ligjvënësi përfshin në numrin e veprave penale ato sjellje të njeriut që paraqesin rrezik për shoqërinë dhe që cenojnë të drejtat e caktuara ose interesa të rëndësishme shoqërore. Rrezikshmëria e veprimeve dhe e mosveprimeve është një kategori objektive, në kuptimin që përcaktimi i saj bëhet në bazë të kushteve dhe ligjeve objektive dhe jo në bazë të qëndrimeve subjektive të subjekte të veshur me pushtet. Pra ligjvënësi është ai që vlerëson rast pas rasti se cilat janë veprimet apo mosveprimet që paraqesin rrezikshmëri shoqërore duke i kriminalizuar këto veprime nëpërmjet ndryshimeve në ligjin penal. Duke iu kthyer veprës penale konkrete për të cilën është akuzuar i pandehuri, rezulton se legjislatori ka vlerësuar se ato veprime që paraqesin rrezikshmëri shoqërore dhe që ka dashur t’i kriminalizojë janë veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me ligjin, dhe jo veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me aktet normative të tjerë me fuqi më të ulët se ligji.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga përmbajtja e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” për të cilën është akuzuar i pandehuri, vlerëson se legjislatori nuk e ka parashikuar se vepër penale “Shpërdorim detyre”, sipas nenit 248 të K.Penal përbëjnë edhe veprimet apo mosveprimet në kundërshtim me aktet nënligjore apo rregulloret e institucioneve përkatëse, pasi

nga përmbajtja e dispozitës është parashikuar si formë e vetme e kryerjes së veprës penale: “... *veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin*”.

Duke sjellë si argument bindës, Kolegji Penal çmon të përmendi si shembull edhe Kodin Penal Italian, neni 323 i tij, i cili parashikon se: “...*Zyrtari ose i ngarkuari me shërbim publik, që gjatë ushtrimit të detyrës ose të shërbimit, në kundërshtim me një normë të ligjit ose të rregulloreve...*” Pra, legjislacioni Italian, në ndryshim nga yni, ka dashur të kriminalizojë të gjitha veprimet dhe mosveprimet, jo vetëm ato që bien në kundërshtim me ligjin por edhe ato që bien në kundërshtim me çdo rregullore të shkruar, parashikim i cili mungon sipas dispozitës sonë penale, e cila kriminalizon veprën penale të “Shpërdorimit të Detyrës”.

Në këtë kuadër, ky Kolegj çmon të theksojë se, në çdo rast, interpretimi i ligjit penal ka si kriter bazë mbrojtjen e parimit të ligjshmërisë.

Formalisht parimi i mosdënimit pa ligj parashikohet në nenin 7 të Konventës Europiane së të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), si dhe në nenin 29 të Kushtetutës Shqiptare dhe është pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor së bashku me parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtin fakt (ne bis in idem). Një konstatim i tillë është bërë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.41, dt. 29.12.2005, ku ajo është shprehur se: “...*përveç të drejtës për një proces të rregullt ligjor (nenit 42), disa nga të drejtat e tjera kushtetuese individuale që parashikohen në nenet 29, 31, 32, 34 etj., të Kushtetutës shfaqen njëkohësisht edhe si aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese, konfirmon edhe një herë qëndrimin e saj, se pretendimet për shkeljen e parimeve themelore që përmbajnë këto të drejta themelore individuale, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, janë objekt shqyrtimi në këtë gjykatë....*”.

Parimi latin *nullum crimen nulla poena sine lege* (mos dënimi pa ligj) gjen sanksionim në nenin 7 të KEDNj-së me formulimin: “1. *Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim që në çastin kur është kryer nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës kombëtare ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që është i zbatueshëm në çastin kur vepra ka qenë kryer. 2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi fajtor për një veprim, i cili, në çastin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.*”. Ky nen afirmon jo vetëm ndalimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, por afirmon edhe parimin e ligjshmërisë. Ky i fundit, i detyron shtetet që t’i përkufizojnë veprat penale, në formën e normave abstrakte dhe të qarta, të mishëruara në ligj. Ligji duhet jo vetëm të parashikojë ekzistencën e veprës penale por edhe të përcaktojë llojin dhe kufijtë e masës së dënimit.

Edhe Kushtetuta Shqiptare i ka bërë një sanksionim të ngjashëm. Kështu në nenin 29 të saj ajo sanksionon se: “1. *Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej si e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave penale, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare. 2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale. 3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese*”. Ky nen ndahet në tre paragrafë, në të cilët sanksionohet parimi *nullum crimen*,

nulla poena sine lege. Konkretisht paragrafi i parë sanksionon *nullum crimen sine lege* (nuk ka veprë penale pa ligj), paragrafi i dytë parashikon *parimin nulla poena sine lege* (nuk ka dënim pa ligj) dhe paragrafi i tretë parashikon parimin se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese, duke ndaluar kështu fuqinë prapavepruese të ligjit penal jo favorizues.

Shprehje e zbatimit të këtij parimi është fakti që, legjislacioni jonë penal ndalon zbatimin e përgjegjësisë penale me analogji. Në nenin 1/c pika 2 të Kodit Penal parashikohet se: *“Zbatimi i ligjit me analogji nuk lejohet”*.

Shprehje tjetër e parimit të mësipërm është edhe ndalimi i termave të paqartë në ligjet penale (Nullum crimen, nulla poena sine lege certa). Kjo do të thotë, se elementët e krimit dhe dënimi përkatës duhet të përcaktohen qartë në ligj. Kjo kërkesë plotësohet kur nga formulimi i dispozitës përkatëse, dhe në rast se është nevoja, me ndihmën e interpretimit nga ana e gjykatës, individi ka mundësi të dijë, se cilat veprime apo mosveprime do ta bëjnë atë penalisht përgjegjës, qëndrim ky i mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e sipërcituar.

Për këto arsye, Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përmbledhen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Ky Kod përmban jo vetëm parimet kryesore mbi të cilat duhet të mbështetet drejtësia penale, por edhe veprat të cilat konsiderohen si të dënueshme. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimit për një veprë që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Qëllimi i këtij parimi është jo vetëm respektimi i ligjit për çdo rast dhe për çdo veprë penale, por edhe njohja e subjekteve me të gjitha ato veprime apo mosveprime, të cilat konsiderohen të dënueshme. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.3, dt. 05.02.2010, është shprehur, se duke qenë se Kodi Penal, krahas Kushtetutës, është burimi kryesor i së drejtës penale dhe në zbatim të parimit të ligjshmërisë, parashikimi i veprave penale duhet të bëhet pikërisht në këtë Kod, si ligji bazë që parashikon krimet dhe kundërvajtjet penale ose në një ligj të barazvlefshëm me të nga fuqia juridike. Një gjë e tillë i vjen në ndihmë shtetasve, të cilët mund të orientohen më mirë në kuadrin e gjerë të ligjeve që mund të parashikojnë vepra penale, me qëllim njohjen e tyre me ndalimet ligjore sipas fushave të ndryshme. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur kjo gjykatë kur është shprehur se: *“...Në rastin e ligjit penal, i cili si rregull kufizon lirinë individuale, është shumë e nevojshme që çdo qytetar të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij si dhe sanksionet që mund t'i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Ai nuk duhet të ndjejë për asnjë çast rrezikun që një ligj i ri penal që mund të parashikojë si të dënueshëm një veprim apo mosveprim të caktuar ose që mund të rëndojë pozitën e tij si i pandehur, do të ketë në të ardhmen fuqi prapavepruese”*.

Për sa më sipër, ky Kolegj çmon të analizojë veprimin e kryer prej të pandehurit Myqerem Tafaj vetëm nën dritën e dispozitave ligjore të Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kështu, dispozita ligjore e referuar nga ana e organit të akuzës, neni 44 i Ligjit nr.9741, dt. 21.05.2007 *“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar me ligjet nr.9832, dt. 12.11.2007 dhe nr.10307 dt. 22.07.2010, parashikon: *“...1. Hapja e programeve të reja të studimeve të të gjitha cikleve të arsimit të lartë privat, mbyllja dhe riorganizimi i tyre bëhen me*

urdhër të ministrit të arsimit dhe shkencës, në bazë të kërkesës së arsimit të lartë.... 2. Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcakton dokumentacionin që duhet të përmbajë projekti i paraqitur për dhënien e lejes për hapjen e programeve të reja dhe që ka të bëjë me misionin e objektivat afatgjatë të institucionit, programet e studimeve, skemën e financimit, si dhe afatet e procedurat për shqyrtimin e projekteve. 3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i kërkon Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë të paraqesë vlerësimin e tij për programet e studimit, të paraqitura në projekt. 4. Ministri i Arsimit dhe Shkencës refuzon një projekt kur: Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë jep vlerësim negativ për të gjitha programet e studimeve....”

Së pari: Ky Kolegj vëren se, nga interpretimi literal, por edhe ai logjik dhe sistematik i dispozitës së sipërcituar, së bashku me dispozitat e tjera të Ligjit nr.9741, dt. 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjet nr.9832, dt. 12.11.2007 dhe nr.10307 dt. 22.07.2010, rezulton se, hapja e programeve të reja të studimeve është në diskrecion të Ministrit të Arsimit, duke iu njohur atij në këtë mënyrë kompetenca ekskluzive vendimmarrëse.

Kolegji arriti në këtë konkluzion nisur nga interpretimi sistematik, literal e gramatikor i nenit 44 të sipërcituar, i cili, ndërkohë që në paragrafin e tij të parë sanksionon qartazi kompetencën ekskluzive të ministrit të arsimit, në ushtrim të funksioneve të tij, për të vendosur hapjen, riorganizimin apo mbylljen e programeve të reja të studimeve të të gjitha cikleve të arsimit të lartë privat, në paragrafin e katërt, të cilit i është referuar organi i akuzës, përdor termin “*një projekt refuzohet*”, term i cili është i ndryshëm nga “*një program nuk hapet*”. Leximi i këtij paragrafi nuk mund të bëhet i veçuar nga pjesa tjetër e dispozitës dhe as nga dispozitat e tjera të të njëjtit ligj. Qartazi, në ndryshim me çka pretenduar akuza, paragrafi i katërt i nenit 44 të Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i referohet refuzimit të një projekti në tërësi dhe jo moshapjes së një programi. Një projekt i paraqitur për miratim përpara Ministrisë së Arsimit nga një institucion i arsimit të lartë privat, mund të përmbajë në vetvete disa programe, ndaj dispozita përdor termin: “*...kur ka dhënë vlerësim negativ për të gjitha programet e studimeve.*”. Qartazi kjo dispozitë parashikon se, ***kur të gjitha programet në përmbajtje të një projekti janë vlerësuar negativisht prej Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, atëherë refuzohet i gjithë projekti.***

Në çështjen objekt gjykimi nuk ndodhemi përpara këtij rasti pasi, ashtu siç pretendohet edhe prej vetë akuzës, Shkolla e Arsimit të Lartë Privat “Vitrina”, në kërkesën e saj ka kërkuar hapjen e tetë programeve të reja të studimit, prej të cilave për 4 degë Këshilli i Akreditimit ka dhënë vlerësim negativ, për një vlerësim pozitiv dhe për tre të tjera ka dhënë vlerësim pozitiv me kushte.

Kështu, nga provat e administruara në gjykim rezultoi se, Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë, me vendimin nr.192, dt. 24.06.2011 ka vendosur për tre prej degëve të kërkuara, përkatësisht Inxhinieri Elektrike, Mekatronikë dhe Administrim Publik, që Bachelor të mos hapen, në Stomatologji Master i Shkencave të mos hapet, Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Arabe të hapet, ndërsa për degët Inxhinieri Ndërtimi, Mjekësi dhe Farmaci nuk ka dhënë një vlerësim

përfundimtar por i ka lënë disa kushte dhe detyrën që pasi t'i plotësojë ato të vërë në dijeni Këshillin e Akreditimit në mënyrë që ky të ribëjë procedurën e verifikimit. Në këto kushte, ky Kolegj vëren se, nuk ndodhemi përpara kushteve të parashikuara nga neni 44/4 i Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, pasi, për sa kohë që këshilli i akreditimit nuk ka dhënë vlerësim negativ për të gjitha programet por vetëm për një pjesë të tyre, nuk kishte përse të refuzohej projekti në tërësi, ndaj nuk mund të flitet për shkelje të tij prej të pandehurit Myqerem Tafaj. Në të kundërt, në rast se i pandehuri, ashtu siç pretendohet prej organit të akuzës, do të kishte refuzuar projektin e subjektit “Vitrina” për hapjen e tetë programeve të reja të studimit edhe pse Këshilli i Akreditimit nuk kishte dhënë vlerësim negativ për të gjitha këto programe, atëherë do të kishim një veprim të tij në kundërshtim me ligjin.

Së dyti: Akuza në mbështetje të pretendimeve të saj i është referuar nenit 62 të Ligjit për arsimin e lartë, dispozitë ligjore kjo e cila parashikon procedurën e akreditimit dhe jo atë të hapjes së programeve të reja të studimeve, e cila parashikohet në nenin 42 të po të njëjtit Ligj. Ky Kolegj vëren se në çështjen objekt gjykimi kjo dispozitë nuk mund të aplikohet për sa kohë që organi i akuzës pretendon si fakt penal hapjen e programeve të reja të studimit dhe jo akreditimin e tyre. Jo vetëm që kompetenca për hapjen e programeve të reja i përket me ligj ekskluzivisht ministrit, por në asnjë dispozitë ligjore nuk parashikohet detyrueshmëria e vendimit të Këshillit të Akreditimit në marrjen e këtij vendimi prej ministrit. Përkundrazi, ligjet e sipërcituara i njohin Këshillit të Akreditimit kompetenca jo vendimmarrëse në këtë procedurë por vlerësuese, edhe vendimi që merr ky organ pasi vlerëson kërkesën parashikohet prej ligjit si vendim negativ, pozitiv ose pozitiv me kushte duke kërkuar plotësimin e mëtejshëm të kushteve, dhe jo si pranim apo refuzim. Në asnjë rast, në asnjë dispozitë ligjore që i referohet Këshillit të Akreditimit për sa i takon hapjes së programeve (nga ana e organit të akuzës ngatërrohet hapja e programeve me akreditimin, ky i fundit është në kompetencë të Këshillit të Akreditimit) nuk përdoret termi vendim por vlerësim. Vetë neni 44 i Ligjit, paragrafit të katërt të të cilit i është referuar akuza, në paragrafin e tretë të tij parashikon: “...3. *Ministria e Arsimit dhe Shkencës i kërkon Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë të paraqesë vlerësimin e tij për programet e studimit, të paraqitura në projekt...*”. Në analizë të dispozitave ligjore dhe procedurës së parashikuar nga ligji i posaçëm për hapjen e një programi të ri, që nga paraqitja e kërkesës prej institucionit të arsimit të lartë privat e deri tek nxjerrja e urdhrit prej ministrit, roli i Këshillit të Akreditimit është ai i një organi të specializuar, i përbërë nga ekspertë të fushës, i cili bën një vlerësim të kërkesës përpara se organi vendimmarrës, ministri i arsimit, të vendosë në lidhje me të.

Pra ky organ nuk ka kompetenca vendimmarrëse pasi vendimmarrja në asnjë rast nuk i njihet këtij këshilli por ministrit.

Edhe në nenin 42 të të njëjtit ligj, mbi hapjen, mbylljen, riorganizimin dhe përshtatjen e programeve të studimeve së të gjitha cikleve të arsimit të lartë publik, (dispozitë të cilës duhet t'i referohej organi i akuzës dhe jo nenit 62) parashikohet: “1. **Hapja e programeve të reja të studimeve të të gjitha cikleve të arsimit të lartë publik, riorganizimi dhe mbyllja e tyre bëhen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesës së institucionit të arsimit të**

lartë. Ministri i Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë t'i kërkojë institucionit publik të arsimit të lartë hapjen e programeve të reja të studimeve në fusha prioritare. 2. Përshatja e programeve/profileve të studimeve të miratuara sipas këtij ligji, që nuk cenon objektivat bazë të tyre, bëhet me propozimin e njësisë bazë dhe me miratimin e këshillit të njësisë kryesore, pasi të merret pëlqimi i senatit akademik të institucionit të arsimit të lartë. 3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës merr vendim, sipas pikës 1 të këtij neni, mbështetur në vlerësimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë”, duke theksuar edhe një herë se kompetenca në marrjen e këtij vendimi i përket ministrit, dhe se vlerësimi i Këshillit të Akreditimit i shërben atij në funksion të kësaj vendimmarrjeje.

Pra, ndërkohë që akreditimi, si një procedurë e posaçme, e cila zhvillohet jo në fillim por tre vjet pas hapjes së një programi të caktuar, në momentin para marrjes së diplomave prej studentëve, është atribut vendimmarrja për të cilin i takon Këshillit të Akreditimit, hapja sipas ligjit, është kompetencë vendimmarrëse e ministrit.

Arrihet në këtë konkluzion jo vetëm nga interpretimi i dispozitave ligjore të sipërcituara, por duke patur parasysh dhe mënyrën se si ato janë zbatuar në praktikë, në vazhdimësi, çka u dëshmuua përpara këtij Kolegji edhe nga dëshmitarët e thirrur në gjykim.

Kështu, i pyetur në gjykim, dëshmitari Bardhyl Musai (Drejtues i Këshillin të Akreditimit, pranë Agjencisë Publike të Akreditimit, që nga viti 2007 deri në fillim të vitit 2014) ka deklaruar: “...Këshilli i Akreditimit në bazë të ligjit është një bord ekspertësh, është i pavarur, nuk jep llogari, vendimet e tij janë kolegjiale dhe janë rekomanduese, nuk kanë formë ekzekutive. Kjo referuar ligjit për “Arsimin e lartë” të vitit 2007.... Puna jonë është e mbyllur, **hapja është e drejtë ekskluzive e ministrit. Ministri dhe mund ta hapë. Vendimet tona nuk janë detyruese.**”. Pyetjes së gjykatës nëse mund të ndodhte që n.q.s. Këshilli i Akreditimit jep vlerësim negativ, Ministri të merrte një vendim pozitiv, ky dëshmitar i është përgjigjur: “**Ministri është personi që e shpreh, ai e ka këtë të drejtë**”. Po kështu, dëshmitarja Edlira Late (anëtare e Këshillit të Akreditimit pranë Agjencisë Publike si përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit) ka deklaruar: “**Vendimi i Këshillit është një vendim rekomandues, ky më pas përcillet në dikasterin përkatës, për të vijuar sipas rregullave të përcaktuara sipas nenit 62 të ligjit.**”. Pyetjes së gjykatës nëse ndodhte që Këshilli të jepte përgjigje negative dhe ndërkohë nga Ministri të dilte urdhër që të hapeshin programet ose e kundërta, kjo dëshmitare i është përgjigjur: “**Është tagër e ministrit ta bëjë legjtim.**”

Gjithashtu, në gjykim është pyetur edhe dëshmitari Avni Meshi (Drejtori i Agjencisë Publike të Akreditimit, Shtator 2010 –Shkurt 2014), i cili ka deklaruar: “...Agjencia është ngritur në vitin 1999, por më të plotë kuadrin ligjor, e ka me ligjin e vitit 2007. Fryma e ligjit është e ndarë në dy pjesë, neni 44 i ligjit, (agjencia për hapjen e programeve, që shqyrton përmbajtjen e programit dhe pjesa kryesore e saj është akreditimi (neni 62)”. Pyetjes së Prokurorit se kush vendoste për hapjen e programeve, ky dëshmitar i është përgjigjur: “**Atë e ka ministria, ne bënim vetëm një vlerësim në përmbajtjen e programeve. Akreditimi është ekskluzivitet i Këshillit. Përveçse e formalizon ministri.**” Pyetjes së gjykatës nëse funksioni i K.Akreditimit është këshillimor apo

vendimmarrës, ky dëshmitar i është përgjigjur: «**Ligji e ka ndarë, neni 44 hapje dhe neni 62 akreditim. Bënim vlerësim në përmbajtje**».

Në gjykim është pyetur dhe dëshmitari Arian Shahini (Drejtori i Zhvillimit të Arsimit Privat, e më pas këshilltar pranë Ministrit), i cili pyetjes nëse, në rast të një mendimi negativ, pozitiv apo me kusht nga Këshilli i Akreditimit, siç ishte dhe për subjektin “Vitrina” (që ka kërkuar hapjen e 8 programeve) ku për hapjen e një programi ka qenë mendimi pozitiv, për hapjen e katër programeve të tjera ka qenë negativ dhe për tre programe ka qenë vendimi me kusht, a ndodhte të vendoste hapjen ministri, ky dëshmitar i është përgjigjur: “*Për rastin konkret nuk e di, por ka pasur devijime rast pas rasti*” Pyetjes se cili ishte roli i KA, dëshmitari i është përgjigjur: “**Rekomandues.** *Ne për të asistuar subjektet, para shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, dërgonim dokumentacion dhe për mësimdhënie*”. Pyetjes nëse vendimmarrja e KA-së çfarë detyrimi passjell, dëshmitari i është përgjigjur: “*tregon se ky subjekt, plotëson apo jo kushtet*”, ndërsa pyetjes nëse kur jepet vendim me kusht, pra që subjekti të plotësojë kushtet dhe për një kohë të caktuar, ky lloj vendimi është rekomandues? Është diskrecion i Ministrit?, ai i është përgjigjur: “**Diskrecion i Ministrit**”.

Së treti: Ky Kolegj vëren se, siç me të drejtë është pretenduar nga i pandehuri dhe mbrojtësja e tij, në çështjen objekt shqyrtimi kemi të bëjmë me një procedurë administrative, të zhvilluar përpara organit kompetent shtetëror bazuar jo vetëm në Ligjet e posaçme të fushës por edhe në K.Pr.Administrative, i cili parashikon se: “...1. *Organet administrative sipas dispozitave të këtij Kodi marrin vendime për të gjitha çështjet brenda juridiksionit të tyre të ngritura nga personat privatë në lidhje me: a) çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti personave privatë; b) çdo petition, kërkesë apo ankim për shkëlqje të Kushtetutës, të ligjit ose në mbrojtje të interesave publike.*”, (neni 15 i K.Pr.Administrative). Po kështu, në nenin 80 të këtij Kodi parashikohet se: “1. *Procedura hetimore zhvillohet nga ai organ administrativ në kompetencën e të cilit është marrja e vendimit përfundimtar*”, ndërsa në nenin 135 të tij: “1. *Personat privatë kanë të drejtë të kërkojnë revokimin, shfuqizimin ose modifikimin e akte administrative në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Kod. 2. E drejta e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të ushtrohet në mënyrat e mëposhtme: a) me anën e një kërkesë formale drejtuar punonjësit ose e joorganit përgjegjës për aktin; b) me anën e një ankimi drejtuar organit që ka nxjerrë aktin e ankimuar ose eprorit të punonjësit/organit përgjegjës, organit kolegjal kur punonjësi përgjegjës është anëtar i tij dhe organit delegates.*”.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se nxjerrja e urdhrit nr.381, dt. 05.08.2011 “Për hapjen e programeve të ciklit të parë që përfundojnë në Bachelor dhe programeve të ciklit të dytë që përfundojnë me Master i Shkencave, të Shkollës së Lartë Private “Vitrina”.”, nuk është një veprim i tillë që të konsiderohet si veprim në kundërshtim me ligjin dhe që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës në kuptim të nenit 248 të K.Penal.

Gjykata çmon të theksojë se dispozita e sipërcituar, e pretenduar nga organi i akuzës, nuk parashikon një detyrim ligjor, i cili të jetë shkelur prej të pandehurit. Sipas kësaj dispozite,

parashikohet vetëm një rast, një detyrim, refuzimi i projektit në tërësi kur për të gjitha programet e parashikuara në të është dhënë vlerësim negativ, dhe asnjë rast tjetër në kuadër të refuzimit pjesërisht apo të hapjes ose jo të programeve. Në këtë kuptim, ushtrimi i pushtetit diskrecional të dhënë dhe të pakufizuar në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk mund të konsiderohet ushtrimi i kësaj të drejte jo vetëm si veprim në kuptim të nenit 248 të K.Penal, por as si veprim në kundërshtim me ligjin.

Në kuptim të nenit 248 të K.Penal për të cilin është akuzuar i pandehuri Myqerem Tafaj, veprimi nënkupton kryerjen e një veprimi që sipas ligjit apo ligjeve që normojnë funksionin konkret i pandehuri nuk duhet ta kryente. Në rastin konkret dispozita ligjore së cilës i referohet prokuroria nuk parashikon se i pandehuri ka detyrimin për të refuzuar hapjen e programeve të tjera kur Këshilli i Akreditimit ka dhënë për disa prej tyre vlerësim negativ dhe për disa pozitiv, ndaj nuk mund të flitet në rastin konkret për veprim në kundërshtim me ligjin.

Bazuar në sa është arsyetuar më lart, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vëren se, pretendimi i parashtruar nga organi i akuzës se, kundërligjshmëria në veprimet e subjektit qëndron edhe në faktin se ka tejkaluar tagrin e funksioneve të tij duke anashkaluar vlerësimin e Këshillit të Akreditimit, i cili njëkohësisht për dhënien e këtij vendimi është bazuar në vlerësime nga ekspertë sipas fushës që mbulojnë, është i pabazuar në ligj.

Në këto kushte, veprimi i të pandehurit Myqerem Tafaj nuk është kryer në kundërshtim me ligjin, duke passjellë kështu mungesën e njërit prej elementëve thelbësorë të anës objektive të veprës penale për të cilën ai është akuzuar.

Veç kësaj, në përgjigje të pretendimeve të ngritura nga organi i akuzës, ky Kolegj vëren se:

Veç sa më sipër, në mënyrë që të ndodhemi përpara veprës penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, ashtu siç është shprehur edhe në fillim të analizës së saj kjo gjykatë, duhet të jetë kryer nga ana e të pandehurit veprimi apo mosveprimi, i cili, përveç elementëve që duhet të ketë në vetvete, pra të jetë në kundërshtim me ligjin dhe të përbëjë mospërmbushje të rregullt të detyrës, duhet gjithashtu të jetë i tillë që të ketë sjellë si pasojë dëmtimin e interesave të personave fizikë, juridikë apo shtetit, ose të ketë sjellë përfitime të padrejta, materiale ose jomateriale, për të pandehurin ose ndonjë person tjetër.

Bazuar në parimin latin “*Nullum crimen, nulla poena sine causa*” (Nuk ka krim, nuk ka dënim pa shkak), lidhja shkakësore, si një nga tre elementët e domosdoshëm të anës objektive të figurës së veprës penale e parashikuar në nenin 13 të K.Penal, vendos kushtin për ekzistencën e përgjegjësisë penale. Si e tillë ajo mund të përfytyrohet si një segment me dy skaje me pikë nistore shkakun, veprimin apo mosveprimin e kundraligjshëm dhe pikë fundore pasojën. Lidhja shkakësore shpreh pikërisht marrëdhënien që krijohet mes këtyre dy elementëve.

E thënë ndryshe, lidhja shkakësore mund të kuptohet si marrëdhënia e varësisë që ekziston mes veprimit ose mosveprimit dhe pasojës përfundimtare të ardhur në një ngjarje konkrete, çka do të thotë se ekzistenca e pasojës shoqërisht të rrezikshme duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve të të pandehurit dhe se po të mos ekzistonin veprimet konkrete të kryera prej këtij të

fundit, nuk do të ekzistonte as pasoja. Ashtu si edhe çdo element tjetër i veprës penale, lidhja shkakësore duhet të provohet. Pra, në çdo gjykim duhet të evidentohet lidhja mes veprimit apo mosveprimit dhe pasojës së ardhur në çështjen konkrete objekt gjykimi, në mënyrë që vepra penale e parashikuar nga ligji të konsiderohet e kryer nga autori i veprimit apo mosveprimit.

Në ndryshim me çka pretenduar organi i akuzës në gjykim, ky Kolegj vëren se, jo çdo veprim i kryer në kundërshtim me ligjin apo aktet nënligjore që normojnë veprimtarinë e të pandehurit përbën veprën penale të shpërdorimit të detyrës, por duhet domosdoshmërisht që nga ky veprim të ketë ardhur si pasojë ose nxjerrja e përfitimeve materiale ose jomateriale të padrejta prej vetë të pandehurit ose për persona të tjerë, ose dëmtimi i interesave të ligjshëm të shtetit, shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, pasojë e cila në rastin konkret mungon. Nga ana e organit të akuzës u pretendua përpara këtij Kolegji se veprimet e të pandehurit kanë sjellë si rrjedhojë hapjen e programeve mësimore të cilat nuk janë në përputhje me kriteret ligjore, krijimin e mundësisë subjektit privat “Vitrina” që pavarësisht se nuk plotësonte standardet ligjore të zgjeronte aktivitetin në fushën e arsimit dhe të ofronte programe jo cilësore studimi, me pasoja financiare për individët dhe për shtetin si garant i standardeve të larta mësimore.

Ky Kolegj vëren se, nga provat e administruara në gjykim, përkatësisht, në dokumentacionin e SHLP “Vitrina” rezulton se në vitin 2011-2012 janë pranuar të rinj në vitin e parë 80 studentë në stomatologji, 37 studentë në mjekësi dhe 97 studentë në farmaci (degë këto për të cilat KA nuk kishte dhënë vlerësim përfundimtar po i kishte kërkuar subjektit plotësimin e kushteve që të shprehej më pas). Nga dokumentacioni i Grupit të Monitorimit, bashkangjitur Raportit të Monitorimit për SHLUP “Vitrina” ka rezultuar se, në Inxhinieri Elektrike (KA ka dhënë vlerësim të mos hapet ndërsa i pandehuri ka urdhëruar hapjen dhe plotësimin e kushteve) 61 studentë, Mekatronikë 92 studentë, Inxhinieri Ndërtimi 89 studentë (MA nuk ishte shprehur me vlerësim përfundimtar i pandehuri ka urdhëruar hapjen me kushte) 89 studentë, ndërkohë që programi i Gjuhës dhe Letërsisë Arabe nuk është hapur asnjëherë.

Nga ana e organit të akuzës u pretendua se, nxjerrja e urdhrit nr.381, dt. 05.08.2011 prej të pandehurit është bërë në mënyrë fiktive pasi ka rezultuar se programet e cituara në urdhër janë hapur disa vite para daljes së këtij urdhri, ndërkohë që i pandehuri jo vetëm që nuk e ka ndaluar zhvillimin e programeve të filluara me mungesa të theksuara teknike dhe ligjore por e ka legjitimuar veprimtarinë e tij.

Në lidhje me këtë pretendim, ky Kolegj vëren se, fakti që këto programe studimi ishin hapur dhe studentët ishin regjistruar dhe kishin bërë pagesat vite përpara se të bëhej ky urdhër nuk mund të konsiderohen si pasoja të këtij urdhri por pasoja të veprimtarisë së paligjshme të ushtruar nga vetë subjekti “Vitrina”. Vërtetohet fakti i mësipërm pasi, në degët e pretenduara nga prokuroria kanë filluar studimet në vitin 2009 ndërkohë që urdhri i ministrit është i vitit 2011. Ky urdhër maksimumi passjell vitin e parë në vitin 2011-2012, pra mund të konsiderohet si pasojë e tij fillimi i këtij viti. Vetë fakti që brenda 6 muajsh nga dalja e këtij urdhri, në të njëjtat degë janë marrë diploma (në vitin 2012) kur duhet të kishte filluar viti i parë, është veprimtari në kundërshtim me ligjin e subjektit “Vitrina” por jo pasojë e këtij urdhri.

Gjithashtu, nga ana e organit të akuzës u pretendua se, edhe pse në pikën 5 të urdhrin është shprehur se: “*Shkolla e Lartë Private Vitrina dërgon në MASH Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri një raport për plotësimin e kushteve të vëna nga Këshilli i Akreditimit*”, nga hetimet e kryera ka rezultuar se këto kushte nuk janë plotësuar nga Shkolla e Lartë “Vitrina” dhe as nga ana e ministrisë nuk ka patur një proces mbikëqyrjeje në lidhje me plotësimin ose jo të këtyre kushteve. Kolegji vëren se mosplotësimi i kushteve prej universitetit “Vitrina” nuk mund të konsiderohet pasojë e këtij urdhri, për sa kohë që në vetë urdhrin e pretenduar, pika pesë parashikohet shprehimisht detyrimi i Shkollës “Vitrina” që brenda 6 muajve të njoftojë MA për plotësimin e kushteve të parashikuara në shtojcën bashkangjitur këtij vendimi, të njëjtat kushte të vendosura nga Këshilli i Akreditimit. Mospërmbushja e detyrimeve prej këtij subjekti privat nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi penale të pandehurin. Kundërligjshmëria e një veprimi shihet në momentin e kryerjes së tij. Në kushtet kur nuk provohet se i pandehuri ka qenë në dijeni, ka parashikuar se këto kushte nuk do të plotësoheshin, veprimet apo mosveprimet e kryera prej subjektit privat “Vitrina” nuk mund të vlerësohen si të nxitura prej tij.

Po kështu, në lidhje me pasojat financiare të shkaktuara individëve, studentëve të regjistruar në degët përkatëse pranë Fakultetit “Vitrina”, ky Kolegj vëren se, së pari nga ana e organit të akuzës është pretenduar se ka patur një dëm financiar por pa u evidentuar, konkretizuar e aq më pak provuar vlera e tij. Pasoja, në rastin konkret, dëmi financiar i pretenduar, si element i anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, ashtu si edhe çdo element tjetër i saj, duhet të provohet. Në mënyrë që të konkludohet në një vendim fajësie, gjykata, në përfundim të gjykimit nuk duhet të jetë e dyzuar për mundësinë e kryerjes së veprës nga i pandehuri, në të kundërt, çdo dyshim çmohet në favor të tij.

Neni 6, paragrafi 2, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut parashikon se çdokush që akuzohet për një vepër penale do të prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia e tij sipas ligjit. Ky parim sanksionohet dhe në nenin 30 të Kushtetutës sonë dhe nenin 4 të K.Pr.Penale. Gjykata Kushtetuese në një sërë vendimesh të saj, si vendimi nr.4, dt. 07.02.2004, vendimi nr.9, dt. 08.04.2004, vendimi nr.19, dt 18.09.2008, nr.23 datë 23.07.2009, etj., është shprehur se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe ky parim (parimi i prezumimit të pafajësisë) do të konsiderohej i cënuar nëse barra e provës do të kalonte nga akuza tek i pandehuri. Gjithashtu ky parim nënkupton ndër të tjera se barra e provës i takon palës akuzuese, çdo dyshim duhet të çmohet në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza.

Dyshimi në favor të të pandehurit (*In dubio pro reo*), nënkupton se kur faktet dhe rrethanat e çështjes lejojnë vlerësime e interpretime të ndryshme, duhet pranuar ai interpretim që është më i favorshëm për të pandehurin.

Prezumimi i pafajësisë është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ-ja (*Shih vendimet e GJEDNJ-së Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 Shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 Qershor 2001*), e cila ka theksuar se “prezumimi i pafajësisë” është një nga

elementet e procesit të rregullt ligjor që parashikohet në nenin 6, paragrafi 2, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor, përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal, mjafton të ekzistojë një arsyetim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja. Në mbrojtje të parimit të prezumimit të pafajësisë, është detyrë e organit të akuzës të provojë në gjykim ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, përfshirë edhe pasojën si element i anës objektive të saj, detyrë kjo e cila nuk u realizua në rastin konkret.

Për më tepër, marrëdhënia e pretenduar është një marrëdhënie juridiko civile, kontraktore, mes SHLP “Vitrina” dhe secilit student, e cila mund të zgjidhet mes atyre palëve në zbatim të K.Pr.Civile dhe së dyti, këto pasoja në rastin konkret nuk kanë ardhur duke patur parasysht Udhëzimin nr.33, dt. 19.09.2014 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në institucionet e Arsimit të Lartë Publik e Privat.....” me të cilin janë njohur programet e studimit të pretenduara si pasojë nga akuza, pra këto programe janë vlerësuar si të rregullta dhe në përputhje me kriteret ligjore.

Ky Kolegj vëren se, pretendimi i organit të akuzës se si pasojë e urdhrit të të pandehurit janë hapur programe jo në përputhje me kriteret ligjore nuk u provuar në gjykim, përse kohë nuk i takon akuzës të bëjë këtë përcaktim por ekspertëve përkatës të arsimit. Siç me të drejtë është pretenduar prej të pandehurit dhe mbrojtëses së tij, në dy raportet e monitorimit të hartuara nga MASH, në vitet 2012 dhe 2013, nuk ka asnjë rekomandim apo sugjerim në lidhje me shkeljet e kryera ose jo nga ky subjekt. E po kështu, vetëm pak muaj pas nxjerrjes së urdhrit të pretenduar, me vendimin nr.317, dt. 16.03.2012, Këshilli i Akreditimit ka dhënë vlerësim pozitiv për të njëjtat programe, çka krijon dyshim mbi mungesën e plotësisht të kushteve prej tyre, dyshime këto të cilat në çdo rast shkojnë në favor të të pandehuri, bazuar në parimin e prezumimit të pafajësisë.

Nga sa është arsyetuar më lart, Gjykata arrin në konkluzionin se veprimet dhe mosveprimet e të pandehurit nuk përbëjnë veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, ndaj në bazë të nenit 388/b të K.Pr.Penale, ai duhet të deklarohet i pafajshëm.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 384 dhe 388, pika 1, germa b, të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Myqyrem Tafaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar në nenin 248 të K.Penal.

Tiranë, më 14.04.2016

ANËTAR
Evelina QIRJAKO

ANËTAR
Artan BROCI

KRYESUES
Tom NDRECA

ANËTAR
Majlinda ANDREA

ANËTAR
Shkëlzen SELIMI